

KONTRATË
MBI ‘‘THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË’’
‘‘CANDY TOURS’’

Sot, me datë **23/04/2024**, në Shkodër, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

Z. Erjon Kërçi, shtetas shqiptar, lindur më **23/01/1980** në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër **I00123047D**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe **Z. Silver Prea**, shtetas shqiptar, lindur më **21/06/1991** në Shkodër dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J10621097W**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosën të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anëtarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Emri i shoqërisë së thjeshtë është **"Candy Tours"**, këtu e më poshtë e quajtur **"Shoqëria"**. Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.



NENI 2
Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Gjuhadol, nr. Pasurie 5/294, zona kadastrale 8593, Shkodër 4001.**

Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

NENI 3
Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë; Pike informacioni për turistat. Transport turistash. Ture turistike. Shitje paketash turistike. Shitje biletash. Makina me qera.

NENI 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

NENI 5
Kapitali Themelor dhe Ortakët

Kapitali i Shoqërisë është 1'400'000 Lekë (nje milion e katerqind mije). Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportet e mëposhtme;

- nga Z. Erjon Kërçi, 50% e kapitalit, me 1 kuotë, 700'000 leke kapital;
- nga Z. Silver Prela, 50% e kapitalit, me 1 kuotë, 700'000 leke kapital.

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.



NENI 6
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

NENI 7
Administratori



Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Znj. Fatma Dema, shtetas shqiptar, lindur më **28/07/1994** në Shkodër dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J45728103H**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Mandati i Administratorit është për një periudhe prej 5 (pesë) vitesh, nga data **23.04.2024 – 23.04.2029**. I rinovueshem, dhe, nese është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



NENI 8
Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe përfundon me 31 Dhjetor 2024.

NENI 9
Të ndryshme

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

ORTAKËT E SHOQËRISË

ERJON KËRÇI


Erjon Kërçi

SILVER PRELA


Silver Prela